

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **“DIGITAL MAX” SH.P.K.**

Sot, ne Tirane, me **date 12/07/2021** , me cilesine e ortakut te vetem themelues te shoqerise:


**-CAMPERIO CONSULTING MIDDLE EAST S.A.L (OFF SHORE)** shoqeri e themeluar ne Liban sipas legjislacionit perkates me ortaket si me poshte :

1. Z.Geo Pierre Atallah , shtetesia libaneze , lindur ne Achrafieh , ne vitin 1967 me numer regjistri 41,Laylaki
2. Z.Oreste Severgnini , shtetesia Italiane lindur ne Milano ne vitin 1942
3. Znj.Lynn Pierre Atallah, shtetesia libaneze , lindur ne Beirut ne vitin 1987 me numer regjistri 41,Laylaki
4. Camperio Family Office (Holding) S.A.L perfaqesuar nga z.Geo Pierre Atallah regjistruar me 07.06.2019 ne regjistrin tregtar ne Beirut me numer 1903983

Ka vendosur themelimin e shoqerise “ **DIGITAL MAX**” sh.p.k.

Me nenshkrimin e ketij Akti Themelimi te nje shoqerie tregtare, nenshkruesi dhe themeluesi i saj merr persiper te realizoje e te respektoje te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga klauzolat e meposhtme, te cilat do te specifikohen gjeresisht ne Statutin e shoqerise:

#### **THEMELIMI I SHOQERISE**



Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" te ndryshuar, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "**DIGITAL MAX**" **sh.p.k** (me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria") nga Ortaku i vetem themelues te saj.

### **FORMA E SHOQERISE**

Shoqeria "**DIGITAL MAX**" **sh.p.k**, me poshte e referuar si "Shoqeria", eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar krijuar ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite Tregtare", dhe rregullohet prej ketij ligji, dhe statutit te shoqerise si dhe prej cdo dispozite tjeter ligjore te aplikueshme.

### **II EMRI I SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA**

#### **Neni 1**

##### **Emri**

Emri i shoqerise eshte "**DIGAL MAX**" **sh.p.k**. Ne cdo dokument, fature, reklame dhe publikime emri i shoqerise do te pasohet nga:

- (i) fjala "me pergjegjesi te kufizuar" apo "sh.p.k"
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

#### **Neni 2**

##### **Selia**

 2

Selia administrative e shoqerise do te jete ne: **Rruga Mine Peza Kompleksi Usluga, Sektori I, kati I 3, Tirane.**

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise **“DIGITAL MAX” sh.p.k** eshte **pa afat**. Ortaku i vetem ka te drejte te kufizojte kete afat duke zbatuar procedurat per ndryshimin e Statutit.

### **III OBJEKTI I SHOQERISE**

#### **Neni 4**

#### **Objekti**

- 1.1.** Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin shqiptar do te jete:
- Aktivitete të teknologjisë se informacionit, prodhimin, tregtimin e pajisjeve dhe sistemeve informatike e kompjuterike hardware dhe software; Aktivitete sipas VKM Nr. 730, date 12.12.2018: Dizenjim software-i; Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software; Testim software; Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit; Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise: Zhvillim sistemesh migrimi; Permiresim/upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suporti i perdorimit dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software. tregti me shumice e pakice i paisjeve teknologjike, telekomunikacioni, kompjuterike, etj. Programim dhe implementim i sistemeve të informacionit.
  - Mirmbajtjen e te gjithë komponenteve qe ne funksion te tyre realizojne qellimin e zgjedhjes informatike
  - Testim software. Këtu përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software; ç) Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Këtu përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike

(LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN);

- Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse;
- Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari që do të konsiderohet nga ortaket si e nevojshme dhe e pershtatshme për arritjen e objektivit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Shqiptar.

Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë edhe çdo veprimtari që do të konsiderohet nga ortaket si e nevojshme dhe e pershtatshme për arritjen e objektivit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Shqiptar.

#### **IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI**

##### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100.000 (njëqind mijë) leke.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 kuote me një vlerë nominale si më poshtë:

**-CAMPERIO CONSULTING MIDDLE EAST S.A.L - 1 KUOTE ME VLERE  
100.000 LEKE**

**OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:**

**CAMPERIO CONSULTING MIDDLE EAST S.A.L - 100 %**

##### **Neni 6**

##### **Organizimi**



Shoqeria do te drejtohet nga nje Administrator. Kete detyre do ta kryej per periudhen e pare prej **5 vjetesh**, i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise.

**ORTAKU I VETEM**

**“CAMPERIO CONSULTING MIDDLE EAST S.A.L (OFF SHORE)”**

**PERFAQESUAR ME PROKURE TE PERGJITHSHME ME NR3122/2021**

**NGA MARISA NITO**

*Marisa Nito*

**ADMINISTRATOR** *Anton Mehmeti*

*9*